

Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Psikologjike

Rezultatet e të nxënit BSc. Psikologji

Në përputhje me Standardet e Akreditimit (SoA), programi BSc. Psikologji bazohet në rregullat dhe kompetencat e kërkuara nga APA dhe EuroPSY. Gjithashtu pikë referuese ka edhe ENOP (Rrjeti Evropian i Psikologëve të Punës dhe Organizimit) dhe EFPA (Federata Evropiane e Shoqatave të Psikologëve). Sipas EuroPSY, programet bachelor në fushën e psikologjisë duhet të jenë “të përkushtuara në orientimin e studentëve në drejtim të degëve dhe fushave të ndryshme të psikologjisë, po ashtu edhe disiplina të ndryshme duke pasqyruar qasjen ndërdisiplinore.

Njohuritë dhe aftësitë psikologjike ofrohen në tre fusha të gjera:

- individët,
- grupet, dhe
- sistemet/shoqëria.

Ky program përfshin katër objektiva të bazuara në aftësi dhe një objektiv të përqendruar në përmbajtje:

- **Objektivi 1:** Baza e njohurive në Psikologji
- **Objektivi 2:** Hulumtimi shkencor dhe të menduarit kritik
- **Objektivi 3:** Përgjegjësia etike dhe shoqërore në një botë diverse
- **Objektivi 4:** Komunikimi
- **Objektivi 5:** Zhvillimi profesional

Brenda lëndëve të ndryshme do të përfshihet përmbajtje që lidhet me fushën ndërdisiplinore dhe multidisiplinore. Një studentë me diplomë bachelor në Psikologji nga Kolegji Heimerer do të ketë këto kompetenca:

- Do të jetë në gjendje të përdorë në mënyrë të duhur konceptet dhe proceset e psikologjisë.
- Do të jetë i pavarur në planifikimin dhe zbatimin e hulumtimeve.
- Do të jetë në gjendje të identifikojë vlerësimet psikologjike, të përshtatshme për grupet e synuara të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve.
- Do të jetë në gjendje të identifikojë qasjet kryesore të psikoterapisë që funksionojnë më mirë për grupet specifike të synuara.
- Do të zhvillojë sjellje etike dhe shoqërisht të përgjegjshme për mjediset profesionale që përfshin diversitet gjithnjë e në rritje.

- Të punojë në mënyrë të pavarur, të organizojë dhe planifikojë punën e vet brenda afateve të caktuara, në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet etike të psikologjisë.
- Të përcjellë materialin kryesor të lëndës si me gojë, ashtu edhe me shkrim për audienca të ndryshme.
- Të tregojë një qasje kritike ndaj njohurive dhe praktikës aktuale në fushën e psikologjisë.

Njohuritë

- Të jetë në gjendje të përshkruajë konceptet kryesore, parimet dhe teoritë e mëdha të disiplinës për të shpjeguar fenomenet psikologjike.
- Të jetë në gjendje të shpjegojë perspektivat kryesore të psikologjisë, qasjet teorike dhe të vlerësojë shpjegime të ndryshme teorike duke i krahasuar me njëra-tjetrën (p.sh. biologjike, kognitive, sjellore, sociokulturore etj.).
- Të jetë në gjendje të kuptojë qasjet kryesore psikoterapeutike.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë aplikimin e psikologjisë në jetën e përditshme.
- Të jetë në gjendje të shpjegojë prirjet historike në disiplinën e psikologjisë.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë gjetjet kryesore empirike në psikologji.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë karakteristikat bazë të shkencës së psikologjisë dhe të shpjegojë metodat e ndryshme të kërkimit të përdorura nga psikologët.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë parimet etike që lidhen me të gjitha aspektet e shkencës dhe praktikës së psikologjisë.
- Të zotërojnë njohuri specifike në fusha të veçanta të psikologjisë (p.sh. kognitive, neuroshkencë, zhvillimore etj.).

Aftësitë

- Të jetë në gjendje të aplikojë perspektiva të ndryshme psikologjike në analizën dhe përshkrimin e fenomeneve.
- Të jetë në gjendje të identifikojë vlerësime psikologjike për grupe të caktuara të synuara.
- Të jetë në gjendje të identifikojë qasje psikoterapeutike të përshtatshme për t'u përdorur për grupe të caktuara të synuara.

- Të jetë në gjendje të hartojë, të zbatojë, të interpretojë dhe të vlerësojë kërkime që adresojnë pyetje psikologjike.
- Të demonstrojë aftësi efektive të shkrimit dhe të komunikimit verbal në formate të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.
- Të jetë në gjendje të praktikojë sjellje etike dhe të zbatojë standardet etike në të gjitha aspektet e shkencës dhe praktikës së psikologjisë.
- Të jetë në gjendje të tregojë përgjegjësi shoqërore në një botë të larmishme.
- Të përdorë në mënyrë efektive të menduarin kritik për të vlerësuar cilësinë e informacionit, për të njohur gabimet në arsyetim dhe për të bërë lidhje mes vëzhgimeve, fakteve dhe teorive.
- Të jetë në gjendje të aplikojë përmbajtjen dhe aftësitë psikologjike në punën profesionale në kontekste të ndryshme.
- Të përfshijë faktorët sociokulturorë në kërkimin shkencor kur është e përshtatshme.

Objektivat dhe rezultatet e të nxënit të listuara më sipër janë planifikuar bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për Arsimin e Lartë, niveli 6, ky niveli ofron diplomë Bachelor.

Sipas rregullores aktuale për licencim, studentët me një diplomë Bachelor në këtë nivel nuk kanë mundësi të pajisen me licencë të psikologut klinik. Standardet kombëtare për licencim në psikologji janë përcaktuar vetëm për psikologët klinikë (me diplomë master) dhe licencat jepen nga Ministria e Shëndetësisë në Kosovë.

Ministria e Drejtësisë në nivel profesional ofron licenca për të diplomuarit e nivelit BSc. Psikologji si ofrues të shërbimeve familjare dhe sociale.